



KONTRATE THEMELIMI  
PER

SHOQERINE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR.

" GENT GRAFIK " SH.P.K.



- K O N T R A T E -

PER THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
" GENT GRAFIK " SH.P.K.

Sot , me date \_\_\_\_\_ 2001 , ne Tirane, une shtetasi shqipta,  
ANGJELO KAZO i biri Gjenci dhe Aferdita i dat. 5 Maj 1968 lindur  
dhe banues ne Gjirokaster , mbeshtetur ne dispozitat e Ligjit  
nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" vendosem  
themelimin e Shoqerise me Pergjegjesi te kufizuar " GENT GRAFIK "  
SH.P.K. sipas kontrates se meposhtme :

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "GENT GRAFIK "SH.P.K. qe ne  
dispozitat e meposhtme do te permendet vetem shoqerija , krijohet  
dhe do te ushtroje aktivitetin e saj tregetar ne perputhje me  
legislacionin e Republikes se Shqiperise.

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes ne rrugen  
"Shyqyri Ishmi" banese private dykateshe Nr.62/1  
Emertimi i shoqerise do te jete "GENT GRAFIK " SH.P.K.

NENI 3

Shoqeria themelohet me mjetet monetare vetaike te ortakut  
themelues.Kapitali themeltar i shoqerise ne shumen 100.000 leke  
eshte investuar nga ortaku i vetem Z. ANGJELO KAZO ne masen 100 %

Ne raportet e mesiperme do te ndahet fitimi i realizuar nga  
aktiviteti i shoqerise apo do te perballohen humbjet e shkaktuara.  
Administrator i shoqerise eshte Z. ANGJELO KAZO.

NENI 4

Objekti i veprimatrise se shoqerise do te jete :

- Botime dhe shtypshkrime ,import eksport tregetimin e te  
gjitha paisjeve dhe materialeve tipografike dhe shtypshkronje,  
kancelari me shumice dhe pakice.

- Tregetim te paisjeve kompjuterike, elektroshtepiake me shumice  
dhe pakice.

- Projekte me ndertime te objekteve civile inudstrialet,  
kanalizime, ujsjellesi

- Import eksport prodhim dhe tregetim te artikujve te ndryshem  
industriale, ushqimor, buqesor, e blektoral fruta perime me shumice  
dhe pakice,tregetim ne fushen e ushqimit social, Bar Bufe restorant

NENI 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise ,emertimi i saj dhe qendra e zhvillimit te aktivitetit, nuke mund te ndryshoje pa miratimin e ortakut te vetem ne menyren e parashikuar nga ligja.

NENI 6

Kohe zgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per nje periudhe kohe te pakufizuar.

Ajo mund te pushoje aktivitetin e saj tregetar kur jane rastet e parashikuara ne ligj ose me pelqimin e ortakut themelues.

NENI 7

Me vendim te ortakut themelues shoqeria mund te hapi seli sekondare, filiale apo forma te tjera shoqerish,sipas cmimit te saj, si brenda ashtu edhe jashte vendit, ne perputhje me legjislacionin e vendeve perkatese.

NENI 8

Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve me pasurine e saj deri ne nivelin e plote te mjeteve monetare e financiare qe ka ne pronesi.

NENI 9

Ortaku i vetem ne marreveshje me te tjeret mund te shtoje apo te pakesoje pjeset e kapitalit dhe ne raport me te edhe fitimet apo humbjet.

NENI 10

Pjeset e kapitalit jane lirish te transferueshme dhe ne rruge trashegimie. Transferimet e pjesave te kapitalit themelor duhet te vertetohen me akt notarial.Ne kete rast zbatohen dispozitat e neneve 45,46 te Ligjit "Per shoqerite tregetare" .

NENI 11

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- Vendimet e ortakut te vetem.
- Administratori i shoqerise.

NENI 12

Kompetencat e vendimeve te ortakut te vetem dhe te administratorit te shoqerise do te percaktohen hollesisht ne Statutin e Shoqerise.

NENI 13

Perfaqsimi i shoqerise me te tretet para organeve shteterore e atyre gjyqsore, maredheniet me banken do te mbahen nga administratori i shoqerise apo personi i autorizuar prej tij.

NENI 14

Shoqeria per kryerjen e aktivitetit te saj do te punesoje persona te tjere. Maredheniet midis tyre dhe shoqerise do te rregullohen nepermjet kontrates se punes qe do te lidhen ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 15

Shoqeria nuke e nnderpret aktivitetin e saj tregetar kur falimenton apo shfaq paaftesi ortaku i vetem ose personi i punesuar. Ne rast se vdes ortaku i vetem aktiviteti i ortakut te vdekur vazhdohet nga trashegimtaret ligjore te cilet dalin ne baze te vendimit te Gjykates.

NENI 16

Rastet e parashikuara shkurt apo te paparashikuara do te zgjidhen sipas ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare"

NENI 17

Mosmarreveshjet midis ortakut te shoqerise dhe te punesuarve ne te si dhe midis shoqerise dhe personave te trete do te zgjidhen ne rrugen e bisedimeve paraprake e ne rast te kundert nga seksioni perkates i gjykates se shkalles se pare te rrethit gjyqor Tirane.

NENI 18

Kontrata e themelimit perpilohet ne kater kopje te barazvlefshme

ORTAKU      THEMELUES

T H E M E L U E S I

/ ANGJELO KAZO /





## S T A T U T I

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" GENT GRAFIK " SH.P.K



- S T A T U T I -

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " GENT GRAFIK " SH.P.K.

Mbeshtetur ne dispozitat e Ligjit 7638 date 19.11.1992 "per shoqeriste Tregetare" ortaku i vetem ANGJELO KAZO shtetas shqiptar me banim ne qytetin Gjirokaster kane themeluar Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "GENT GRAFIK " SH.P.K. sipas Kontratës se Themelimit qe shoqeron kete STATUT.

FORMA , BAZA JURIDIKE , SELIA

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "GENT GRAFIK "SH.P.K. qe ne dispozitat e meposhtme do te permendet vetem me termin "shoqerija" formohet nga ortaku i vetem ANGJELO KAZO i biri Gjendi , i dat. 5 Maj 1968 lindur dhe banues ne Gjirokaster.

NENI 2

Shoqeria eshte krijuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe si person juridik e fillon aktivitetin me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar te Gjykatës se Rrethit Tiranë.

NENI 3

Selia e shoqerise eshte ne qytetin Tiranës ne rrugen "Shyqyri Ishmi" banese private dy kateshe Nr. 62/1.

Me vendim te ortakut te vetem themelohet shoqeria e cila mund te hape seli sekondare ,filiale apo forma te tjera shoqerish si brenda ashtu edhe jashte vendit ne perputhje me legjislacionin e vendeve perkateze.

NENI 4

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar,Kontraten e themelimit dhe Statutin dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore qe rregullojnë marrëheniet perkateze.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj,objektin e veprimtarise dhe emertimin vetem me vendimin e ortakut te vetem dhe sipas menyrës te parashikuar me ligj.

Administratori i shoqerise eshte Z. ANGJELO KAZO.

FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT TE VETEM

NENI 5

Fusha e autoritetit te ortakut te vetem dhe perqindja e fitimeve ose e humbjeve do te kete si kriter baze kapitalin e shoqerise si dhe kompetencat qe gezojne ne marrjen e vendimeve te cdo karakteri te percaktuar ne Statut.

LIBRI I SHOQERISE

NENI 6

Per te precizuar e saktesuar veprimtrine e vet ekonomike si dhe marredheniet me te tretet dhe ate te punes, shoqerija do te celi librin e vet, i cili do te quhet libri i shoqerise.

KONFIDENCIALITETI

NENI 7

Ortaku i vetem dhe personat e tjere te punesuar ne shoqeri, bien dakort qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqerija, kontratat qe ajo do te lidhe ,si dhe planet apo qellimet e saj per te ardhmen.

NENI 8

Te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxirren nga shoqeri ja dhe te destinuara per te tretet, si letrat ,faturat, lajmerimet dhe publikimet e nderyshme, duhet te tregojne lexueshm emrin e shoqerise dhe pas tij fjalet SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR apo injicalet SH.P.K. dhe emrin e Administratorit.

O B J E K T I

NENI 9

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

- Rotime dhe shtypshkrime, import eksport tregetimin e te gjitha paisjeve dhe materialeve tipografike dhe shtypshkronje, kancelari me shumice dhe pakice.
- Tregetim te paisjeve kompjuterike ,elektroshtepiake me shumice dhe pakice.
- Projekte te paisjeve kompjuterike ,elektroshtepiake me shumice dhe pakice.
- Import eksport prodhime dhe tregetim te artikujve te ndryshem industriale ushqimor,bujqesor blektoral fruta perime me shumice dhe pakice,tregetim ne fushen e ushqimit social Bar bufe restorant.

- 3 -

## KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 10

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe te pa kufizuar duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregetar.

Ajo mund te pushoje aktivitetin e saj tregetar kur jane rastet e parashikuara ne ligje ose me pelqimin e ortakut te vetem themelues.

## KAPITALI THEMELOR

NENI 11

Kapitali themelor i shoqerise eshte ne shumen 100.000 leke.

Ky kapital eshte teresish i neneshkrueshem dhe i shlyer nga ortaku i vetem. Shoqeria apo ortaku i vetem mund te shtoje apo te pakesoje kapitalin e vet me vendim unanim te ortakut themelues.

## K O N T R I B U T E T

NENI 12

Kapitali themeltar perbehet nga kontributet e meposhtme.

Ortaku i vetem ka 100 % te kontributit.

Ne raportin e mesiperme do te merret edhe fitimi i realizuar nga shoqeria apo do te perballohen humbjet eventuale.

## TRANSFERIM I PJESEVE TE KAPITALIT

NENI 13

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem si tek te tretet eji qe ne rruge trashegimie.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te trasnsferueshme edhe ne rast te ndarjes se pasurise midis bashkeshorteve.

Ne cdo rast pjeset e kapitalit te transferueshem duhet te vertetohen me akt notarial.

## STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 14

Shoqeria do te konsideroje vehten e saj si shoqeri NENE e cila rast pas rasti do te hapet me anen e filialeve ose shoqerive te perbashketa ne te gjithe vendin ku do te shikoje interes ne permbushjen e qellimeve te saj si dhe jashte shtetit.

NENI 15

Organet drejtuese te shoqerise jane :  
- Vendimet e ortakut te vetem  
- Administratori i shoqerise.

NENI 16

Ortaku i vetem merr vendime dhe vendos per keto ceshi jnë :

- Mirator bilancin vjetor te shoqerise
- Vendos pershtimin ,pakesimin ,transferimin e kapitalit.
- Emeron dhe shkarkon administrator jashte shoqerise.
- Vendos mbylljen e aktivitetit te shoqerise apo shnderrimin e saj ne nje lloj tjeter shoqerije.

Unanimiteti i ketyre vendimeve eshte i domosdoshem per keto ceshjtje :

- Per rritjen,pakesimin apo transferimin e kapitalit.
- Per mbylljen e shoqerise apo shnderrimin e saj ne nje lloj shoqerie tjeter.

NENI 17

Administratori i shoqerise kryen te gjithe drejtimin e shoqerise.Ai e perfaqson ate ne marredheniet me te tretet,me organet gjyqsore e ato shteterore,bangjen etj.

Per kryerjen e detyrave te vecanta administratori mund te autorizoje persona te caktuar sipas rregullave per perfaqsimin.

Shoqeria merr persiperte gjitha pasojat qe mund te vijne nga veprimet e administratorit.

NENI 18

Administratori eshte pergjegjes para shoqerise apo te terteve kur gjate kryerjes se detyrave te tij shkel ligjin,kontraten e themelimit dhe statutin,shkelje te cilat i kane shkaktuar pasojat morale apo materiale vete shoqerise apo te treteve.

PUNESIMI NE SHOQERI.

NENI 19

Per kryerjen e rregullite te aktivitetit tregetar shoqerija ka te drejte te lidhi marredhenie punesimi me persona te jashtem.

Per punonjesit qe do te punesohen marredheniet juridike midis shoqerise dhe te punesarve do te rregullohen nepermjet kontrates se punes e cila do te lidhet ne perputhje me dispozitat ligjore qe rregullojn keto marredhenie dhe akteve ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te tyre.

NENI 20

Shoqeria merr persiper te derdhni rregullisht te gjitha detyrimet ,gjithashtu dhe kontributet per sigurimin e te punesarve te saj ne organet kompetente shteterore perkatese.

- 5 -

## B I L A N C I

NENI 21

Bilanci mbylljet ne daten 31 Dhjetor te cdo viti.Llogarite vjetore ,inventari,raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar nga ortaku i vetem ,miratohet me vendim te ortakut te vetem

Miratimi i dokumenative mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati 6 mujor nga dita e mbylljes se vitit finanziar.

## D I V I D E N T E T

NENI 22

Pas miratimit te llogarise vjetore dhe evidentimit te egzistences se fitimeve ,qe perbehet nga fitimi i viti finanziar te cilit i jane zbritur shumat e leta per fondin rezerve te dodmosdoshem te percaktuar nga ortaket,si dhe fondeve te tjera qe jane te nevojshme si dhe jane shtuar perkatesisht umbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme ,ortaku percaktojne dividentet e realizuara mbi fitimin.

## SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

NENI 23

Shoqeria mbaron me vendim te Ortakut te vetem ose kur ka shkake ligjore per prisghje te parakohshme dhe pa vullnetin e tij,te percaktuar ne ligje.

NENI 24

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se tuij.Pas kryerjes se ketij procesi ortaket caktojne nje ose disa likujdues,te cilet u paraqesin atyre raportin e aktivit dhe te pasivit te shoqerise mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.Ne perfundim te procesit te likujdimit ,Ortaku i vetem vendos mbi bilancin perfundimtar finanziar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

Pas pagimit te likujdatoreve pjesa e mbetur e kapitalit ndahet ndermjet ortakeve ne report me pjesed faktore te kapitalit.

## ZGJIDHJA E MOSMARREVESHEVE

NENI 25

Te gjitha mosmarreveshjet qe lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit do ti paraqiten per zgjidhje sektionit perkates te Gjykates se rrethit gjyqsore Tirane.

NENI 26

Ky Statut qe nuk ka mbi qytetit te tij.

O R T A K U      T H E M O U L I E S

Angelo Rego  
Q.C.

Disponim

Te verifikohet nese ekziston nje firme me emrin e paraqitur ne kerkese.

Data dhe nenshkrimi i gjyqtarit, gjyqtares

Ne listen e emrave eshte/jane regjistruar me emrin e paraqitur ne kerkese

nje firme  
disa firma  
Nuc ma asnje firme

Gent - Grafik

Data dhe nenshkrimi i sekretares se gjykates

26.3.2001 R Nuci'm'

Get Your Private, Free E-mail from MSN Hotmail at <http://www.hotmail.com>.